



Prishtinë, 24 qershor 2010

Kodi i ZRRE-së: V\_248\_2010

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 15 paragrafi 2 pika (d) dhe nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4 dhe 12 të Rregullit për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja Gjeneruese,
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan” KK Novobërdë, të datës 17.08.2009 të ndërmarrjes Wind Power SH.A, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr.68, hyrja 9, Ulpiana/ Prishtinë, Republika e Kosovës,

në mbledhjen e mbajtur me datë 24 qershor 2010 nxori këtë:

## VENDIM

### Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “**Wind Power SH.A**” ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues nga burimet e ripërtëritshme të energjisë (BRE) nga era me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan” KK Novobërdë.
- II Aplikantit Wind Power Sh.A mund t’i lëshohet AUTORIZIMI për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenin 12 dhe 13 të Rregullit mbi Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues.
- III. Ky Njoftim nuk nënkupton edhe lëshimin e Autorizimit përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën II të dispozitivit të këtij Vendimi.

## Arsyetim

ZRRE me datë 17.08.2009 nga ndërmarrja **Wind Power SH.A**, ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga era, me kapacitet të instaluar prej 900 kW, në lokacionin “Bostan”, zona kadastrale e KK Novobërdë.

ZRRE pas vlerësimit të dëshmimeve të bashkangjitura aplikacionit dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda (14) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRrE-së

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar.